



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 shtator 2023
Nr.ref.: RK 2273/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI60/22

Parashtrues

Luljeta Sokoli

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit Pml.nr.462/21 të 18 janarit 2022 të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Luljeta Sokoli nga Prishtina, e cila përfaqësohet nga Naser Peci avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml.nr.462/21] e 18 janarit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PA1.nr.1280/21] e 10 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.1331/17] e 28 majit 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar [Pml.nr.462/21] të 18 janarit 2022 e ka pranuar më 9 shkurt 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka kërkuar moszbulimin e identitetit të saj, pasi që siç thekson *“ Kërkesa e paraqitur ne Gjykatën Kushtetuese është vetëm një segment i rezultuar nga çështjet interne familjare që janë në proces të shqyrtimit civil (nr.C1745/1 5 dhe nr. C 1637/15) ne Gjykatën Themelore në Prishtinë, andaj me synim te shmangies së dëmtimit eventual te procesit kërkojë mundësin e respektimit të konfidencialitet konformë Rregullores se punës të Gjykatës Kushtetuese, kapitulli III Fillimi i procedurës, Rregulli 32 Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve pika 6”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22(Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
7. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri ne fuqi 15 ditë pas publikimit te saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

8. Më 5 maj 2022, parashtruesja e kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
9. Më 16 mars 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr.GJR.KSH60/22] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [Nr.KSH.KI60/22] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.

10. Më 23 maj 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses për regjistrimin e kërkesës. Po ashtu një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Bazuar në shkresat e lëndës, më 12 prill 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kishte ngritur Aktakuzë [PP/IINr.4003/15] kundër parashtrueses së kërkesës, me pretendimin se ka kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), për shkak se ka vënë në lajthim organin kompetent, përkatësisht Ofiqarin e Komunës së Prishtinës, ashtu që duke paraqitur kërkesë për lëshimin e aktvdekjes të bashkëshortit të saj të ndjerë, dhe duke deklaruar veten në cilësinë e trashëgimtares së vetme të bashkëshortit të ndjerë, ka përjashtuar nga trashëgimia, në mënyrë të kundërligjshme, vajzën e trashëgimlënësit. Për pasojë, organi komunal kishte lëshuar dëshminë mbi vdekjen e trashëgimlënësit, në të cilën parashtruesja e kërkesës ishte shënuar si trashëgimtare e vetme e të ndjerit, duke e vërtetuar kështu një çështje të pavërtetë.
14. Më 28 maj 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.1331/17] shpalli fajtores parashtruesen e kërkesës lidhur me veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,7, 17, 20, 21, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, dhe neneve 359, 365 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK) parashtrueses ia shqiptoi dënimin me burg me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin e verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
15. Më 27 shtator 2021, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që të aprovohet ankesa e saj dhe të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim. Edhe Prokuroria Themelore përmes parashtrësës PPA/II nr.1295/2021 të 15 tetorit 2021 kërkoi të refuzohet ankesa e parashtrueses së kërkesës dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore.
16. Më 10 nëntor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1280/21] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore [P.nr.1331/17] të 28 majit 2021 e vërtetoi.
17. Më 22 nëntor 2021, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të kodit të procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar.1.12 i KPPK-së dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale përkatësisht nenit 432 par.1 nenpar. 1.3 të KPPK-së.

18. Më 18 janar 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.462/2021] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtrueses së kërkesës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml.nr.462/2021] e 18 janarit 2022 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të saj themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
20. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës duke theksuar se Gjykatat e rregullta me theks të veçantë Gjykata Themelore kishte refuzuar pranimin e provave të paraqitura nga ajo, ku lidhur me këtë ajo pohon se *"[...] në pajtim me nenin 329 të KPP në shqyrtim gjyqësor, gjate deklarimit të saj kishte prezantuar prova për të dëshmuar mungesën e elementit subjektiv (dashjes) për të përjashtuar "palën e dëmtuar" nga trashëgimia. Njëkohësisht provat kishin për qëllim të provonin motivin me të cilin ishte udhëhequr parashtruesi i kërkesës për përpilimin e aktvekses ku figuron vetëm ajo si trashëgimtare. Për këtë qëllim kishte ofruar aktvendimin e trashëgimisë T nr.140/82 (baze marrëveshjes familjare për ndarje të pasurisë) dhe fotot e vendndodhjes së pronës së patundshme në Batllave e cila ishte shitur dhe çmimi i shitjes për pjesën e trashëgimtarit i ishte dhënë në tërësi këtu "palës së dëmtuar" A.G. Gjykatësi kishte refuzuar pranimin e atyre provave, por pastaj i kishte lënë në shkresat e lëndës. Edhe pse me rëndësi për të provuar arsyen e përpilimit të aktvekses në formën e cekur gjykata aprovon kundërshtimin e prokurorit dhe refuzon atë prova dhe vendos të veçohen nga shkresat e lëndës. Në momentin e vendosjes gjykata na udhëzoi citat: "keni të drejtë ankese pastaj në Apel"!? Duke marrë për bazë faktin se gjykata ka detyrim ligjor që të vërtetojë elementet qenësore të veprës përfshirë edhe elementin subjektiv apo dashjen me refuzimin e administrimit si prova të dokumenteve të dorëzuara, konsiderojmë se ka shkelur detyrimin e trajtimit të barabartë të palëve para ligjit. Kjo mbase me veprimet e këtitilla (refuzim të provave dhe mos faljes së besimit dëshmisë së parashtruesit të kërkesës me arsyetim se tenton shmangie nga përgjegjësia) ka krijuar mundësinë që të ndërtohet një gjendje e re faktike e cila ka deformuar faktet apo motivin pse aktveksja kishte përmbajtjen e tillë, apo ka deformuar elementin subjektiv të veprës -dashjen dhe nga përmbushja e një obligimi familjar pa baze u përfundua se parashtruesja e kërkesës 'Ika përpiluar aktveksjen me qëllim që e dëmtuara të përjashtohet nga e drejta në trashëgimi'. Realiteti nuk ishte ky si është përfunduar nga gjykatat. Është fakt i provuar që aktveksja e përpiluar nuk është përdorë në ndonjë procedurë nga parashtruesi i kërkesës dhe është fakt që në procedurën kontestimore të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës "pala e dëmtuar" është pale në kontest".*
21. Tutje parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave lidhur me ekzistimin e veprës penale për të cilën ajo është dënuar, kishin interpretuar gabimisht dhe në mënyrë diskriminuese nenin 403 par.1 të KPRK-së, pasi që sipas parashtrueses së kërkesës *"... është provuar se parashtruesi i kërkesës aktveksjen nuk e kishte përpiluar me atë përmbajtje me qëllim që ta përdorë në procedurë trashëgimore për të shpallë trashëgimtare vetëm ajo në 1/3 pjesë të patundshmërisë së evidentuar në emër të ndjerit B.S. Aktveksja ishte dorëzuar si provë në kontestin e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës, ku palë ishte edhe pala e dëmtuar, andaj nuk përbën interpretim të drejtë në kuptimin dhe qëllimin e normës vlerësimi vetëm i vënies në lajthitje të organit kompetent".*

22. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës parashtruesja e kërkesës thekson se “... e drejta për barazi para Ligjit dhe trajtim të barabartë nga ligji, apo parimi i mos diskriminimit e kushtëzon interpretimin dhe zbatimin jo vetëm të së drejtës për të drejtat e njeriut por gjithashtu edhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Parimi i barazisë në radhë të parë nënkupton që çdo person që paraqitet para një gjykate ka të drejtë mos të diskriminohet as në mënyrën se si zbatohet ligji ndaj tij. Në rastin e parashtrueses së kërkesës gjykata e ka diskriminuar si në trajtim ashtu edhe në interpretim të ligjit”.
23. Në fund parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të aprovojë kërkesën si të pranueshme dhe të vlerësojë të njëjtën në kuptim të shkeljeve të pretenduara.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”
- [...]

Kodi nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës

Neni 403 Legalizimi i përmbajtjes së rreme

1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrin apo librin e tillë edhe pse e di së është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

26. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

27. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ajo e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.462/2021] e 18 janarit 2022 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë

shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

28. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

29. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

31. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të

GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [K104/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).

32. Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me aktakuzën e ngritur ndaj parashtrueses së kërkesës nga ana e Prokurorisë Themelore për shkak të pretendimit për kryerjen e veprës penale Legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 403 par.1 i KPRK-së. Gjykata Themelore e kishte e kishte shpallur faktore parashtruesen e kërkesës për kryerjen e veprës penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par.1 i KPRK-së, dhe i kishte shqiptuar dënim me burgim me kusht prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse e dënuara në afatin e verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk do të kryente vepër tjetër penale. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit e kishte refuzuar ankesën dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu edhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga ana e parashtrueses së kërkesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ishte refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme.
33. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

34. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës qëndron në pretendimin se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës, duke arsyetuar “... duke marrë për baze faktin se gjykata ka detyrim ligjor që të vërtetojë elementet qenësore të veprës përfshirë edhe elementin subjektiv apo dashjen me refuzimin e administrimit si prova të dokumenteve të dorëzuara, konsiderojmë se ka shkelur detyrimin e trajtimit të barabartë të palëve para ligjit. Kjo mbase me veprimet e këtilla (refuzim të provave dhe mos faljes së besimit dëshmisë së parashtruesit të kërkesës me arsyetim se tenton shmangie nga përgjegjësia) ka krijuar mundësin që të ndërtohet një gjendje e re faktike e cila ka deformuar faktet apo motivin pse aktudekja kishte përmbajtjen e tillë, apo ka deformuar elementin subjektiv të veprës - dashjen dhe nga përmbushja e një obligimi familjar pa baze u përfundua së parashtruesja e kërkesës ka përpiluar aktudekjen me qellim që e dëmtuara të përjashtohet nga e drejta në trashëgimi”. Realiteti nuk ishte ky si është përfunduar nga gjykatat. Është fakt i provuar që aktudekja e përpiluar nuk është përdorë në ndonjë procedurë nga parashtruesi i kërkesës dhe është fakt që në procedurën kontestimore të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës “pala e dëmtuar” është palë në kontest”.
35. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykatat e rregullta, përkatësisht nenit 403 paragrafi 1 të KPRK-së.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa

gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).

37. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
38. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtrueses së kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
39. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [P.nr.1331/17], shpalli fajtores parashtruesen e kërkesës lidhur me veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 paragrafi 1 i KPRK-së dhe e dënoi me dënim me burgim me kusht prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin e verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, me arsyetimin se "[...] Pretendimet e te akuzuarës se: Dëshmia e vdekjes, pavarësisht rëndësisë që ka në procedure trashëgimore, vetvetiu nuk e përjashton dike nga trashëgimia dhe nuk e shpalle tjetrin trashëgimtar të vetëm.", nuk qëndrojnë, për faktin se në këtë çështje akuza nuk është rreth përjashtimit të të dëmtuarës nga trashëgimia nga ana e te akuzuarës, por vënia në lajthim e organit kompetent përkitazi me saktësimin e përmbajtjes së dëshmi vdekjes nga e akuzuara, ku e njëjta ne momentin e përpilimit te kërkesës për dëshmi vdekje, ne rubrikën ku duhej te shënoheshin trashëgimtarët e pronës se paluajtshme te trashëgimlënësit, edhe pse e ka ditur se trashëgimlënësi, burri i saj i ndjere, ka pasur një vajzë nga martesja e pare, siç. e pohoi edhe vete ajo gjate shqyrtimit gjyqësor, të njëjtën nuk e ka vene ne liste te, për çka organi kompetent ka nxjerre dëshmi vdekje për të ndjerin Burhanidin Sokoli, me te vetëm trashëgimtare Luljeta Sokoli. Pra organi kompetent ne baze të të dhënave te paraqitura nga ushtruesja e kërkesës, ka vërtetuar të dhëna te pasakta duke u vene ne lajthim nga e akuzuara përmes fshehjes se te dhënave, për te cilat ka pasur dijeni se ekzistojnë. Pra e njëjta duke ditur se ekziston edhe një trashëgimtare e te trashëgimlënësit, ne piken 4 te aktvdekjes, shkronja b), ku kërkohet te evidentohen nëse trashëgimlënësi ka fëmije ,martesor, jo martesor dhe te adoptuar, nuk ka evidentuar Ana Gutiq, si vajze te trashëgimlënësit. Se kjo vepër penale është kryer me dashje direkt vërtetohet edhe nga vet deklarata e te akuzuarës e cila pohoi te jete evidentuar vetëm ajo si trashëgimtare ne kërkesë për dëshmi vdekje, sepse "ka qene kërkesë e bashkëshortit tim që të respektohet marrëveshja interne familjare";, e që një deklaratë e tilla është ne kundërshtim me

dëshmi vdekjen, ku ne piken 7 te dëshmi vdekjes, nder te tjera është kërkuar që të shënohet nëse i vdekuri ka lënë testament gojor, dhe të cekën emrat e dëshmitarëve para te cilëve është bere testamenti, nuk është evidentuar asnjë testament gojor apo dëshmitar, siç pohon e akuzuara për marrëveshjen interne familjare dhe testamentin gojor (gjate seancës gjyqësore) " .

40. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1280/21] refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ku ndër të tjera theksoi " [...] Me te drejte gjykata e shkalles se pare ka theksuar se pretendimet e mbrojtjes se dëshmia e vdekjes si dokument i cili vetvetiu nuk përbën dokument me te cilën shpallet automatikisht trashëgimtari është pretendim i pa bazuar. E po ashtu edhe pretendimi se nuk e ka përdor te njëjtën ne asnjë procedure tjetër ligjore që do të përfundonte me vendim me te cilën e akuzuara do te shpallej trashëgimtare e vetme e të ndjerit. Kjo për faktin se dispozita e nenit 403 par. I te KPRK.-se nuk e thekson se medoemos duhet qe përmes dokumentit me përmbajtje te rreme te përfundon edhe veprimi tjetër procedural ne këtë rast shpallja e te akuzuarës si trashëgimtare e te ndjerit Burhanedin Sokoli. " Kjo dispozite qarte thekson se "kushdo qe ven ne lajthim organin kompetent qe ne një dokument publik; regjistër apo libër te 'vërtetoj një çështje te pa vërtetë, te parapare për te shërbyer si prove ne një çështje ligjore dënohet me ". Pra me rendësi është vënia ne lajthitje e organit kompetent me mashtrim apo me ndonjë veprim tjetër, për ta legalizuar një Përmbajtje te pa vërtetë .e ku kryesi i veprës penale me qëllim dhe vetëdije tek organi kompetent krijon përfytyrim të gabuar për ekzistimin apo mos ekzistimin e fakteve juridike relevante. Për te ekzistuar kjo vepër penale nuk është e nevojshme te ekzistoj qëllimi i kryesit që atë dokument, regjistër apo libër edhe ta përdor. Pra për me ekzistua kjo vepër penale është e domosdoshme që organin kompetent ta sjell në lajthitje për ta shtyrë të legalizoj një përmbajtje te pa vërtetë që nënkupton vetëm veprimet e legalizimit publik zyrtar i cili parashihet qe te shërbej si prove ne një çështje ligjore. Ky legalizim i rremë në dokumentin publik kryhet në rastin konkret nga kryesi i kësaj vepre penale. Vepra penale konsiderohet e kryer nga vetë legalizimi i përmbajtjes së rreme në dokumentin publik në rastin konkret në akt vdekje me të dhënat si në dispozitiv të aktgjykimit".
41. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në tërësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Pml.nr.462/2021, ndër të tjera arsyetoi " [...] Në aktgjykimet e kundërshtuara është vlerësuar edhe mbrojta e te dënuarës se aktvdekjen nuk e ka përdorur dhe nuk e ka përpiluar me qëllim qe te përdori, por se arsyeja për se një dokument me këtë përmbajtje e ka kërkuar nga ofiqaria, ka qenë një marrëveshje gojore me bashkëshortin e saj tani te ndjere. Duke e vlerësuar këtë mbrojtje, gjykata e shkalles se pare ka gjetur se vënja në lajthitje e organit kompetent ka ekzistuar, sepse e dënuara ka pranuar se e ka ditur se nuk është trashëgimtare e vetme e pasurisë. Me tutje ka arsyetuar se aktvdekja është një dokument publik i cili shërben si prove ne një çështje ligjore, ne rastin konkret si prove për atë se kush është trashëgimtar i Burhanidin Sokolit. Me pastaj është dhënë edhe arsyetim për atë se nuk është element i veprës penale legalizimi i përmbajtjes se rreme; përdorimi i dokumentit, sepse konform dispozitës se nenit 403 par.1 te KPRK këtë vepër penale e kryen "kushdo qe ve ne lajthim organin kompetent qe ne një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të parapare për te shërbyer si prove ne një çështje ligjore". Gjykata Supreme konstatoje se gjetjet e gjykatës se shkalës së parë të vërtetuar me atë te shkallës se dyte janë ligjore dhe te arsyetuara ne mënyrë te sakte dhe ligjore [...]".

42. Gjykata vëren se Gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, përfshirë edhe pretendimin se nuk ishte bërë interpretim i duhur i nenit 403 par.1 të KPRK-së. Lidhur me këtë Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte qartësuar përmbajtjen e nenit 403 të KPRK-së, i cili qartëson në mënyrë precize se kur kemi të bëjmë me vepër penale “Legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë”, ku ndër të tjera paragrafi 1 i nenit 403 thekson *“kushdo që vë në lajthim organin kompetent që ne një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të parapare për të shërbyer si prove ne një çështje ligjore”*. Gjykata Supreme konstatoje se gjetjet e gjykatës se shkalës së parë të vërtetuar me atë të shkallës së dytë janë ligjore dhe te arsyetuara në mënyrë të sakte dhe ligjore [...]”.
43. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t’i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e saj; ka pasur mundësinë për t’i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
44. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, thekson se, gjykata e *“ka interpretuar gabimisht dispozitën e nenit 403 të KPRK-së”*, megjithatë ajo nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë *“qartazi i gabuar”*, duke rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesen e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).
45. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që bien në kategorinë e *“shkallës së katërt”* dhe si të tilla, këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

46. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë *“të pambështetura apo të paarsyetuara”* ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është

qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#) (vendim) i 31 majit 2005, kërkesa nr. 4241/03; shih gjithashtu, [Baillard kundër Francës](#) (vendim i 25 shtatorit 2008, kërkesa nr. 6032/04);

- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
47. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ka shkelur të drejtat e saj individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 24 të Kushtetutës, duke theksuar “... e drejta për barazi para Ligjit dhe trajtim të barabartë nga ligji, apo parimi i mos diskriminimit e kushtëzon interpretimin dhe zbatimin jo vetëm të së drejtës për të drejtat e njeriut por gjithashtu edhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Parimi i barazisë në radhë të parë nënkupton që çdo person që paraqitet para një gjykate ka të drejtë mos të diskriminohet as në mënyrën se si zbatohet ligji ndaj tij. Në rastin e parashtrueses së kërkesës gjykata e ka diskriminuar si në trajtim ashtu edhe në interpretim të ligjit”, por nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI187/18](#) dhe [KI 11/19](#), parashtrues: Muhamet Idrizi, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [KI125/19](#) parashtrues: Ismajl Bajgora, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [KI175/20](#), parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
48. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtrueses të kërkesës për shkelje neni 24 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, pasi parashtruesja e kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Kërkesa e parashtrueses për mosbulim të identitetit

49. Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesën e saj kishte kërkuar gjithashtu që identiteti i saj të mos zbulohet.
50. Parashtruesja e kërkesës lidhur me kërkesën për mosbulim të identitetit arsyeton si në vijim: “Kërkesa e paraqitur ne Gjykatën Kushtetuese është vetëm një segment i rezultuar nga çështjet interne familjare që janë në proces të shqyrtimit civil (nr.C1745/1 5 dhe nr. C 1637/15) në Gjykatën Themelore në Prishtinë, andaj me synim të shmangies së dëmtimit eventual te procesit kërkojë mundësin e respektimit të konfidencialitet konformë Rregullores se punës të Gjykatës Kushtetuese, kapitulli III Fillimi i procedurës, Rregulli 32 Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve pika 6”.

51. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 24 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Kurdo përgjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar”.

52. Duke u bazuar në arsyetimin e paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata konsideron se kjo nuk është bazë për miratimin e kësaj kërkesë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, [KI74/17](#), parashtrues Lorenc Kolgjeraj, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017).
53. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses së kërkesës për moszbulim të identitetit duhet të refuzohet.

Përfundim

54. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e papranueshme, sepse: (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*” dhe si të tilla këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; dhe (ii) pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Gjithashtu kërkesa për moszbulim të identitetit refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 24 (1), 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani